

Përmbaruesi Privat **Isa Shala**, më datë **12.01.2022** ka sjellë Konkluzion për lëndën P.nr.502/2018, mbi shitjen e paluajtshmërive të hipotekuara në favor të bankës BKT, e evidentuar në Çertifikatën e Pronës me numër të lëndës **05-169/16**, parcela me numër **P-72614046-00311K-0**, me sipërfaqe prej 10,454 m², Zona Kadastrale Mazgit, Komuna Obiliq, e evidentuar në emër të pronarit z. Jakup Querkezi, dhe paluajtshmëria e evidentuar në Çertifikatën e Pronës me numër të lëndës **011/953/71465**, parcela me numër **P-71914075-00267-8**, me sipërfaqe prej 400 m², Zona Kadastrale Çagllavicë, Komuna Prishtinë e evidentuar në emër të pronarit z. Visar Beqiri, të bllokuara/ hipotekuara në favor të kreditorit Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A.

Këto pasuri të përshkruara më lartë do të shiten përmes Ankandit të Dytë Publik, në mbështetje të plotë të dispozitës së Nenit 227 të LPP-së, me qëllim të sigurimit të mjeteve për të përmbushur detyrimet që debitorët Kompania **NTP Lejani – PVC & Dekor** (dhe të tjerët), kanë ndaj kreditorit – **Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A.**

» Vlera e paluajtshmërive është vlerësuar në shumën prej: **196,000.00 €** (një qind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë euro), pasuri të cilat në këtë ankand të dytë të shitjes publike mund të shiten nën vlerën e përcaktuar, por jo nën 1/3 të vlerës së përcaktuar.

■ Data e Ankandit të Dytë Publik: **04.02.2022**

■ Koha e shitjes – ora: **10:00**

■ Vendi i shitjes: **Përmbaruesit Privat Isa Shala, Bulevardi Bill Clinton, Hyrja 270, nr. 2, Prishtinë**

Të gjithë të interesuarit duhet të deponojnë tek Përmbaruesi Privat shumën prej 10 % të vlerës së cekur të paluajtshmërisë por jo më shumë se 5,000 Euro në emër të kaucionit, para se të fillojë shitja, por jo më vonë se data 03.02.2022, me të drejtë të kthimit të kaucionit pas përfundimit të ankandit, ofertuesve të pasuksesshëm.

Për informata me të hollësishme, ju lutem, kontaktoni në tel: 038 666 666; 045/700-790;

Prishtinë, 2022



038 666 666 | www.bkt-ks.com